



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 1-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 11.03.2022, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Gentianë Hoxhaj ,anëtare
2. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
3. Shahadije Bikilqi Dragaçina, anëtare
4. Enver Kryeziu, anëtar
5. Idajet Garip, anëtar
6. Slavisa Trajkovic, anëtar
7. Skender Bikliqi anëtar,
8. Zoran Cirkovic, anëtar
9. Ana Guciq, anëtare

Të tjerë prezent

1. Daut Azemi, kryesues i Kuvendit
2. Lulzim Qermi, nënkryetar i Komunës
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
5. Fisnik Dida, OSBE

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pasi i përshëndeti të pranishmit ,tha se me komitetin për komunitete mandatin e kaluar kemi pasë bashkëpunim te mire presim te vazhdojmë me bashkëpunime dhe ketë mandat. Takimin parë do ta udhëheq unë derisa te zgjidhet kryesuesi i komitetit për komunitete.

Lulzim Qerimi, nënkryetari i komunës tha,se se pari ju uroj për zgjedhjen në këtë komitet, po ashtu shpresoj ne bashkëpunim ashtu siç kemi pas edhe ne mandatin e kaluar duke punuar për te mirën e komunitetit

Lulmturije Bytyqi-Hasani, tha se unë ne mandatin 2009 -2013 kam qenë kryesuese e komitetit per komitete e vetmja shqiptare në atë kohe qe e kam udhëheq këtë komitete dhe këtë komitet e shoh si trup shumë të rëndësishëm dhe si grup i PDK-së jemi për bashkëpunim me te gjitha komitetet për te mirën e këtyre komuniteteve.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se ftesën me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim:

R E N D I T E

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete
2. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi,, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush ndonjë propozim për Kryesues të komitetit për komunitete

Zoran Cirkovic,tha se ne si komitet na mandatin e kaluar kemi punuar ne bazë te planit të punës të cilin e kemi realizuar 95% të atij plani. Me kryesuesin e komitetit të atij mandati Skender Bikliqin kemi qenë shumë të kënaqur pasi qe ka qenë njeri bashkëpunues njeri i sinqerte me te gjitha virtytet e larta dhe prapë e propozoj qe per kryesues te komitetit ta zgjedhim Skender Bikliqin.

Stilavish Trajkovic,tha se ne si komitet kemi kaluar shume mire mandatin e kaluar duke u munduar te bëjmë me të mirën për komunitetin tone, po ashtu me kryesuesin e deritanishëm Skenderin kemi qen shume te kangur me punën e tij dhe propozoj qe i njëjti je jetë prapë kryesues.

Idajet Garip, tha edhe unë pajtohena me parafolësit qe baci Skender të jetë kryesues i këtij komiteti.

Shahadije Dragaçina, tha se edhe unë jam qe Skender Bikliqi të jetë kryesues i këtij komiteti, po ashtu jam i gatshëm qe ti ndihmoj ne çdo aspekt axhit Skender dhe do ta ketë përkrahjen time çdo herë.

Ana Guciç, tha edhe përkrahjen time do ta ketë Skender Bikliqi për kryesues të komitetit për komunitete

Lumturije Bytyqi-Hasani, për bacin Skender me ka fol fjalë të mira ish anëtar i komitetit Lulzim Rrustemi, dhe unë e përkrahi dhe do ta ketë mbështetjen time.

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se unë e falënderoj bacen Skender për bashkëpunimin që kemi pasur dhe do ta ketë ende përkrahjen time çdo herë. Tani duhet ta bëni planin e punës së komitetit i cili plan do të votohet edhe në kuvend.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi e vuri në votim propozimit që kryesuesi i komitetit për komunitete të zgjidhet Skender Bikliqi, dhe pas votimit, u konstatua se Komiteti unanimisht me 9 vota për e zgjodhi Skender Bilqiqin për Kryesues të Komitetit për Komunitete.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, ia kaloi fjalën kryesuesit të po sa zgjedhur.

Skender Biliqi, tha se ju falënderoj te gjithëve për besimin dhe mbështetjen, për mua do të jetë privilegj por edhe një detyrë shtesë, por unë se bashku me juve do të mundohemi që te bëjmë më të mirën për komunitetin të cilin e përfaqësojmë. Po ashtu i falënderoj, Daut Azemin Lulzim Qerimin, te gjithë anëtarët e komitetit, Osce-në, Kforin Sektorin e Kuvendit secilin veç e veç, për mbështetjen e treguar në çdo kohë. Pres mbështetjen tuaj edhe këtë mandat për të mirën e qytetarëve të komunës tonë.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, tha se është mirë në bashkëpunim me OSBE-në me organizua një punëtori dhe aty të diskutoni rreth planit tëpunës së komitetit.

Skender Bikliqi, tha se kemi pas disa takime me përfaqësuesit e OSBE-së, dhe kemi kërkuar organizimin e një punëtorie ku te diskutonim rreth planit të punës dhe çështja tjera që kanë të bëjnë me komitetin.

Fisnik Dida, nga OSBE-ja, tha se ne do të takohemi me Emilijen dhe do të shohim se çka do te mund te bëjmë rreth kërkesave të juaja.

Lulzim Qerimi, tha se unë e kam një propozim që ne planin e punës të përfshin me shumë vizita në teren te komunitetit ku do te shihen me sa afërmi kërkesat dhe nevojat e tyre. Po ashtu te punohet me shumë për komunitetin te cilin e përfaqësoni e jo vetëm ditën kur vini në mbledhje.

Idajet Garip, unë kam menduar që të gjitha kërkesat e komunitetit tim bëhen përmes meje e jo përmes dikujt tjetër.

Daut Azemi, në secilin komitet ka nga një përfaqësues të komunitetit Rom dhe secili qytetar ka të drejtë te ju drejtohet me kërkesa e tyre përfaqësuesve të vet.

Gentianë Hoxhaj, tha se i uroj punë të mbarë bacit Skender, dhe suksese. Ky komitet do ta ketë mbështetjen e grupi të LDK-së, por kërkoj nga ana e përfaqësuesve të komitetit që te respektohet edhe barazia gjinore dhe te ju epet hapësirë edhe gjinisë femërore.

Zoran Cirkovic, tha edhe unë pajtohem me nënkryetarin qe te punohet me shumë ne teren reth komuniteteve dhe te adresohen kërkesat e atyre qytetarëve. Po ashtu te marrim pjesë edhe në dëgjime publike, në dëgjime buxhetore, dhe kudo qe ka nevoja te qytetarëve ti ngrisim në komitet.

Sllavisha Trajkovc, tha se ne kohën e fundit jemi përballur me pandeminë covd 19, vërshimet por prapë si komitet jemi marr me kërkesat e komunitetit të cilin e përfaqësojmë , po ashtu presim qe te jemi aktiv edhe tani me kërkesat e komunitetit të cilin e përfaqësojmë

Daut Azemi ,tha se është mirë qe ju si komitet të bëni sa më shumë vizita në teren si në Grackë, Magure ,Gadime, Janjevë dhe vendet tjera ku banojnë komunitetet dhe ti shihni me afër kërkesat e tyre.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15¹⁵.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi